



William R. Hite, Jr., Ed.D.

Superintendenti

23 Mars 2020

Të nderuar familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Departamenti i Arsimit të Pensilvanisë (PDE) njoftoi sot se të gjitha shkollat në Pensilvani, duke përfshirë edhe Distriktin Shkollor të Filadelfisë, do të qëndrojnë të mbyllura të paktën deri në 6 prill, 2020, si rezultat i përpjekjeve kundër virusit COVID-19.

Ndërsa ndikimi i COVID-19 (koronavirus) në zonën e Filadelfias po intensifikohet, Drejtoria e Arsimit është përqëndruar në gjetjen e mënyrave të reja dhe të drejta, të cilat mund të mbështesin nevojat e nxënësve, familjeve dhe personelit tona ndërsa shkollat qëndrojnë të mbyllura. Udhëzimi që ne po marrim nga Departamenti i Arsimit të Pensilvanisë dhe Departamenti Amerikan të Edukimit është gjithnjë në zhvillim dhe përgjigjet tona do të evoluojnë me sa më shumë informacione dhe udhëzime të disponueshme. Kjo letër ofron një azhurnim të planeve tona deri tani për të gjithë nxënësit.

Ne jemi duke zhvilluar një përvojë mësimi në distancë së bashku me një plan për të siguruar pajisje të barabarta për të gjithë nxënësit. Ne jemi gjithashtu në procesin e organizimit të trajnimeve dhe burimeve virtuale në mënyrë që më shumë mësues të mund të qëndrojnë të lidhur me nxënësit që përdorin Google Classroom. Ne do të ndajmë më shumë hollësira dhe informacione në të ardhmen e afërt.

Ne jemi duke forcuar më tej mënyrat se si t'ju shërbejmë nxënësve dhe familjeve tona gjatë kësaj kohe nga:


- duke zgjeruar përpjekjet tona të linjës telefonike që nga sot për të përfshirë nëntë linja shtesë në gjuhë të ndryshme në mënyrë që më shumë familje të mund të marrin përgjigje për një sërë pyetjesh të përgjithshme në gjuhën e tyre amtare. Linjat telefonike funksionojnë nga e Hëna deri të Enjten në mëngjes nga ora 9:30 deri në 11:30.

- 215-400-5300 - Anglisht
- 215-400-8489 - Spanjisht
- 215-400-8480 - Shqip
- 215-400-8481 – Arabisht
- 215-400-8482 - Kineze
- 215-400-8483 - Frenceze
- 215-400-8484 - Kamboxhiane
- 215-400-8474 - Portugeze
- 215-400-8485 - Rusisht
- 215-400-8486 - Vietnameze

- menjëherë vihet në dispozicion një adresë e re e emailit covid19info@philasd.org ku familjet mund të paraqesin pyetjet e tyre për përgjigje;
- duke krijuar të Martën, 24 Mars, një faqe në internet në www.philasd.org me përgjigje të pyetjeve të bëra më shpesh;
- krijimi i një pakete të re të udhëzuesve (Learning Guides) K-12 (LG) të disponueshëm në internet për nxënësit, që fillon ditën e Mërkurë 25 Mars, dhe në letra në të gjitha 49 shkollat që janë caktuar për të marrë ushqim duke filluar nga e Enjtja, 26 Mars; (*Vendet për vaktet e ushqimit funksionojnë vetëm të Hënë dhe të Enjten nga 9 e mëngjesit deri në mesditë. Tre mëngjeze dhe tre dreka mund të merren për secilin nxënës në familjen tuaj çdo ditë.*)
- Sqarimi i mëtejshëm i ndihmës që mësuesit tanë mund t'u japin nxënësve përfshin: komunikimin me email, telefon, apo platforma të tjera për t'ju përgjigjur pyetjeve në edukim; duke bërë të mundshme përdorimin e programeve të mësimi online të blera nga Drejtoria; caktimin e orëve të zyrës virtuale për individë ose grupe nxënësish që të "takohen" me mësuesit e tyre; dhe sugjerimin e burimeve të tjera që nxënësit t'i përdorin për të mësuar;
- duke ndarë me mësuesit dhe familjet më shumë burime të vetë-drejtuar në internet për t'i mbajtur nxënësit të angazhuar dhe të entuziazuar për të mësuar çdo ditë.

Faleminderit për partneritetin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme, ndërsa ne bashkëpunojmë këto kohë të vështira. Ju lutemi kujdesuni dhe qëndroni të sigurt!

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendenti
Drejtoria Arsimore e Filadelfias